

<b>LLOGARIA E PAGESES ME SHERBIME BAZIKE – KOMISIONE DHE KUSHTE</b>		
	Llogaria e pagesës me shërbime bazike me kushte standarde	Llogaria e pagesës me shërbime bazike me kushte të lehtësuara
<b>LLOGARIA RRJEDHESE</b>		<b>LEK</b>
Hapje llogarie		Falas
Mbyllja e marrëdhënies me Bankën	3 muaj pas hapjes	Falas
	Brenda 3 muajve të hapjes	1,000 LEK
Komisione për mbajtje llogarie rrjedhëse (Falas për muajin e hapjes së llogarisë)		75 LEK
Balance minimale për llogarinë rrjedhëse		1,000 LEK
Komision printimi nxjerrje llogarie <i>Klienti gëzon të drejtën që 1 herë në vit të marrë falas printimin e lëvizjes së llogarisë</i>		100 LEK nxjerrje llogarie për muajin aktual; 200 LEK nxjerrje llogarie për vitin aktual; 500 LEK nxjerrje llogarie për vite të mëparshme
Dërgimi i lëvizjeve të llogarisë në adresën e klientit		100 LEK/ zarf
Kreditimi i normës së interesit në llogarinë rrjedhëse		0
<b>VEPRIME NE SPORTELE TE BANKES/ cash</b>		<b>LEK</b>
Depozitime cash në sportelet e bankës për llogari personale rrjedhëse		Falas
Depozitime cash nga palë të treta në llogari rrjedhëse	Deri në 1,500,000LEK	150 LEK
	Mbi 1,500,000 LEK	750 LEK
Depozitime cash nga klientë të rastit në një llogari rrjedhëse	Deri në 1,500,000LEK	500 LEK
	Mbi 1,500,000 LEK	1,000 LEK
Tërheqje parash në sportelet e bankës nga llogaria rrjedhëse	Deri në 50,000 LEK	65 LEK
	Nga 50,000-300,000 LEK	Falas
	Nga 300,000-1,500,000 LEK	150 LEK
	Mbi 1,500,000 LEK	0.10% (max. 2,000 LEK)
Tërheqje parash në sportelet e bankës nga llogaria me këmbim	Deri në 300,000 LEK	Falas
	Nga 300,000-1,500,000 LEK	150 LEK
	Mbi 1,500,000 LEK	0.10% (max. 2,000 LEK)
Pagesa në cash në llogaritë e Thesarit/Buxhetit* ose pagesa të faturave		150 LEK
Pagesa për Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)		150 LEK
<i>* Përfshihen pagesat e taksave të bashkisë dhe pagesat për Agjencinë Qëndrore për Vlersimin e Aritjeve Studentore dhe Universitetin</i>		
<b>PAGESAT</b>		
<b>PAGESAT NEPERMJET LLOGARIVE TE ISBA</b>		<b>LEK</b>
Pagesa nëpërmjet llogarive të ISBA		70 LEK/ e njejta datë valutë*
Ekzekutimi i pagesave me urdhër debitimi automatik		Falas
<i>*Nuk përfshihen transaksionet në Internet Banking</i>		
<b>PAGESA FATURASH</b>		
Pagesa nëpërmjet debitimit direkt		Falas
Pagesat e faturave utilitare nga llogaria (Pa përfshirë transaksionet nëpërmjet Internetit Banking)		100 LEK
<b>PAGESA NE LLOGARITE E THESARIT/ BUXHETIT*</b>		
Pagesa nga llogaria		50 LEK
Pagesa nga llogaria e klientit për Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)		100 LEK
<i>*Transaksionet në Internet Banking janë të përjashtuara nga pagesa e komisionit</i>		

<b>PAGESA NE MBERRITJE</b>			
Datë valuta për pagesat standarte në mbërritje		E njejta datëvalutë	
Pagesa në mbërritje në LEK		Falas	
<b>PAGESA NE DALJE NE DEGE</b>			
Datë valuta standarte për pagesat në dalje		2 ditë valutë	
Pagesa në dalje në LEK	Shumat deri ne 1,499,999 LEK	500 LEK	
	Shumat nga 1,500,000 LEK e sipër	1,500 LEK	
Investigimi i pagesave		25 EUR për investigim plus komisionet e bankës korrespondente	
<b>PAGESA NE DALJE NEPERMJET KANALEVE ONLINE</b>			
Datë valuta standarte për pagesat në dalje		E njejta datëvalutë*	
Pagesa në dalje në LEK	Për shumat deri në 20,000 LEK	Falas	
	Për shumat mbi 20,000 LEK - 1,499,999 LEK	250 LEK	Falas
	Për shumat mbi 1,500,000LEK	750 LEK	Falas
Investigimi i pagesave		25 EUR për investigim plus komisionet e bankës korrespondente	
*Për date valuten e pagesave të kryera përmes Shërbimit Bankar Dixhital, ju lutemi referojuni seksionit specifik të Kushteve të Punes per Individe			
<b>KARTA DEBITI TE ISBA</b>		<b>VISA INSPIRE</b>	
Transaksione në ATM të Intesa Sanpaolo Bank Albania në Shqipëri		Falas	
Transaksione në ATM jo të Intesa Sanpaolo Bank Albania në Shqipëri		200 LEK	
Transaksione në ATM të Grupit Intesa Sanpaolo		Falas	
Transaksione depozitimi cash në ATM të Intesa Sanpaolo Bank Albania në Shqipëri		Falas	
Limiti Ditor per depozitime cash ne ATM (ne vlere) Depozitimi mundesohet vetem ne monedhen LEK		100,000 LEK	
Limiti Ditor per depozitime cash ne ATM Numer veprimesh		5 transaksione	
Transaksione ne POS dhe Internet (on-line) ne Shqiperi		Falas	
Transaksione ne ATM/POS dhe Internet (on-line) jashte vendit		2.5% e shumës	
Tarifa mujore e shërbimit		75 LEK	Falas
Zëvendësimi i të gjithë kartave/Zëvendësimi i kodit sekret (PIN)		1,000 LEK	
Zëvendësimi i kartës së skaduar		Falas	
<b>SHERBIMI BANKAR DIXHITAL</b>			
Komisioni mujor		Falas	
Komisioni për Software Token		Falas	
Komisioni i lëshimit për Hardware Token		700 LEK	
Pagesat e faturave utilitare nëpërmjet Shërbimit Bankar Dixhital		Falas	
Komision mujor për #withSIGN (Firma e Kualifikuar elektronike)		Falas	
<b>TE TJERA</b>			
Njoftim përmes SMS		50 LEK/ muaj	
Konfirmim bankar për marrëdhënie me Bankën dhe për balancën e llogarisë		1,000 LEK	
Vërtetim që nuk ka marrëdhënie me Bankën		10 EUR	

## LIGJI PER SIGURIMIN E DEPOZITES

Agjencia e Sigurimit te Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA, në bazë të ligjit Nr. 8873 datë 29.03.2002 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar në ligjin Nr. 53/2014 datë 22.05.2014, është pajisur nga Agjencia me Çertifikatën për sigurimin e depozitave Nr. 10, date 11.05.2009.

Në bazë të kësaj çertifikate, Agjencia, sipas nenit 33, paragrafi 1 pika a) të ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", siguron dhe kompenson depozitat e sigurueshme të çdo depozituesi në Bankën "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA në masën 100 për qind, por në çdo rast jo më shumë se 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre, të depozituara në këtë bankë.

### A – SIGURIMI I DEPOZITAVE

"**Depozitues**" bazuar ne Nenin 3, paragrafi 17 të ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" është çdo individ, i cili ka të drejtën e përfitimit të pagesës së një depozite nga një subjekt anëtar i skemës së sigurimit të depozitave, përfshirë këtu titullarin me të drejta të plota të një depozite në bashkëpronësi dhe çdo përfitues të një depozite të palës së tretë.

"**Depozita**" bazuar ne Nenin 3, paragrafi 13 të ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", dhe/ose çdo ligj ndryshues të tij.

"**Depozitë e sigurueshme**", bazuar ne Nenin 3, paragrafi 14 të ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" është vlera e agreguar e të gjitha depozitave të një depozituesi, përfshirë interesin e përlogaritur të tyre në ditën e vlerësimit ose të ndërhyrjes në një subjekt anëtar të skemës, përveç depozitave të përjashtuara nga sigurimi dhe kompensimi nga Agjencia parashikuar në nenin 32 te ketij ligji:

a) pjesa e depozitës në bankë ose degën e bankës së huaj me vlerë mbi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek ose shuma e barasvlershme me të (kundërvlerën), në monedhë të huaj; b) depozitat e bankës, degës së bankës, degës së bankës së huaj dhe shoqërisë së kursim-kreditit në emër dhe për llogari të vet; c) depozitat e drejtorit, administratorit në bankë dhe të afërmit e ngushtë të tyre, sipas përcaktimit në ligjin për bankat; d) depozitat e çdo personi që zotëron 5 për qind ose më shumë në kapitalin e subjektit anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt; e) depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykatë të formës së prerë; f) depozitat e tregtarëve vendas ose të huaj;

ë) depozitat e personave juridikë, vendas ose të huaj; g) depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja; h) depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja; i) depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja; j) tituj të emtuar nga subjekte financiare dhe çdolloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit; k) depozitat e njësisve të pushtetit qendror ose vendor të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj; l) depozitat të paemërtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë; m) depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt; n) depozitat e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë së kursim-kreditit, sipas përcaktimeve në ligjin për shoqëritë e kursim-kreditit, përveç asamblesë së përgjithshme.

### B – KOMPESIMI I DEPOZITAVE

Procedurat e kompensimit, sipas nenit 39, paragrafi 1 të ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", fillojnë menjëherë në momentin kur Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit anëtar të skemës së sigurimit të depozitave në likuidim të detyruar. Kompensimi përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të tij. Agjencia, sipas nenit 33, paragrafi 1 pika a) të ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", siguron dhe kompenson depozitat e sigurueshme të çdo depozituesi në bankë ose në degën e bankës së huaj në masën 100 për qind, por në çdo rast jo më shumë se 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre, të depozituara në këtë bankë.

### C – TERMAT DHE KUSHTET PER PAGESEN E KOMPESIMIT

Niveli maksimal i kompensimit për çdo depozitues, sipas nenit 38, paragrafi 2 të ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" përlllogaritet sipas përcaktimeve të nenit 33 të këtij ligji, duke zbritur shumën e detyrimeve të papaguara në kohë të depozituesit ndaj subjektit anëtar, që rezulton në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës. Agjencia, bazuar ne nenin 38, paragrafi 12 të ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", ka të drejtë të refuzojë kompensimin ose të kërkojë kthimin e kompensimit për depozitat e siguruar, kur e drejta për kompensim bazohet në të dhëna të pavërteta dhe mashtruese dhe kur vëren se nuk ka interes të sigurueshëm. Interes i sigurueshëm është interes i ligjshëm dhe nevoja objektive e depozituesit për t'u mbrojtur nga humbja financiare e depozitave në një ngjarje sigurimi. Agjencia, sipas nenit 39, paragrafi 4 të ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", mund të kompensojë depozitën e siguruar nëpërmjet njërës prej këtyre mënyrave:

- pagesës së shumës në Lek personit në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim në bashkëpunim me likuidatorin;
- pagesës së shumës në Lek personit në ambientet e një banke anëtare të skemës (banka agjente);
- transfertës së shumës që përfitohet nga depozituesi në një bankë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;
- pagesës me çeked)mënyra të tjera pagese të miratuara me akt nënligjor të Autoritetit Mbikëqyrës.

**Shënim:** Ky informacion jepet në zbatim te detyrimi për informimin e publikut nga subjektet anëtare të skemës ne baze të nenit 27 të ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave".